




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR SEMAN

VENDIM

Nr. 30, datë 16.11.2023

PËR



**MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR
SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM HIDROENERGJETIK
SUBJEKTI “IDI 2005” SH.P.K**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujqor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujqor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujqor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujqore, Këshilli i Basenit Ujqor Seman.

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes për përdorim burimi ujqor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik subjekti “Idi 2005” sh.p.k, sipas Kontratës me Nr. 1461 Rep., Nr. 338 Kol., datë 02.11.2021 “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Arçova”, me kapacitet 1280 KW, në përroin e Arçovës, degë e përroit të Seltës dhe Holtës, , Bashkia Elbasan, Qarku Elbasan”.



Treguesit paraprak janë si më poshtë:

HEC Arçova

Vendndodhja e veprës së marrjes 1/ burimi ujqor Lumi Devoll

- X= 520187.27; Y= 4536949.48; Z=485 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse: 0.73 m³/s
- Prurja mesatare vjetore: 0.6 m³/s
- Prurja ekologjike: 0.09 m³/s

Vendndodhja e godinës së Centralit

- X= 517658.25; Y= 4533190.51; Z=252 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja që shkarkohet: 0.73 m³/s
- Prodhimi vjetor i parashikuar: 4.078.447 kwh/vit
- Fuqia e instaluar: 1280 kwh
- Vlera totale e investimit: 229,898,003 lekë pa TVSH.

3. Zbatimi i kontratës nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBU SEMAN



LEFTER SHEHAJ